




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://eeë.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në bazë të nenit 29 dhe 31 të Statutit të Komunës së Gjilanit, 01. Nr.16-53125 të datës 11.11.2011, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 16.04.2014, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 24.04.2014, miraton këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KËSHILLIT TË EKSPERTËVE PËR PLANIFIKIM ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË GJILANIT DHE PLANIFIKIM URBAN TË QYTETIT TË GJILANIT

Neni 1.

1. Për sigurimin e kushteve për planifikim të qëndrueshëm dhe të barabartë hapësinor të territorit të Komunës së Gjilanit, mbështetjes profesionale dhe shkencore të dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe dokumenteve tjera, Formohet Këshilli i ekspertëve për planifikimin zhvillimor të Komunës së Gjilanit dhe Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Gjilanit (në tekstin e mëtejme: Këshilli) si Organ konsultativ i Kuvendit të Komunës së Gjilanit, në përbërje prej:

1. Agim Salihu-LDK
2. Artan Hoxha-LDK
3. Xhelal Jetishi-LDK
4. _____PDK
5. _____PDK
6. Agim Zuzaku-AAK
7. Arsim Miftari-LVV
8. Besnik Keka-Shoqria civile
9. Ermida Ismajli-Shoqria civile

2. Këshilli përbëhet prej kryetarit, zëvendës kryetarit dhe 7 anëtarëve nga radha e personave profesional, shkencor, publik dhe personave tjerë kompetent për planifikim hapësinor.
3. Këshillin e udhëheqë dhe e kryeson kryetari i Këshillit, kurse në mungesë të tij, zëvendësi i kryetarit të Këshillit.
4. Përbërja e këshillit duhet të reflektojë barazi gjinore dhe mundësi të barabarta.
5. Kuvendi me vendim të veçantë emëron personat e lartshënuar si anëtarë të këshillit.

6. Këshilli ka për detyrë të:

- jep mendime, propozime dhe vërejtje në dokumentet e planifikimit hapësinor (Planin Zhvillimor të Komunës, Planet zhvillimore për zona të veçanta dhe Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit) dhe në dokumentet tjera të përcaktuara me Ligjin për Planifikim Hapësinor të Kosovës të cilat i nxjerr: Qeveria e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Kuvendi i Komunës dhe organet e tij nga fusha e planifikimit hapësinor, e që kanë ndërlidhje me territorin e Komunës së Gjilanit.
- shqyrtojë dhe propozojë zgjidhje përkatëse në rastet e mos harmonizimit të strategjive zhvillimore për sektor të ndryshëm të rëndësishëm për planifikimin hapësinor.
- përcjell dhe kujdeset për procedurat nëpër të cilat duhet të kalojnë dokumentet e planifikimit hapësinor të cilat miratohen nga organet e Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës, Kuvendit dhe Qeverisë të Komunës së Gjilanit dhe organeve të tij, në

vështrim të Ligjit për planifikim hapësinor dhe akteve tjera nga fusha e planifikimit hapësinor.

- kryej edhe punë tjera që dalin nga aktet juridike të organeve kompetente nga fusha e planifikimit hapësinor.

7. Këshilli duhet t'i raportojë Kuvendit të Komunës për punën e vetë.

8. Kompensimi për anëtarët e Këshillit

- Këshilli është organ konsultativ i Kuvendit, kështu që kompensimi për punën e Këshillit do të caktohet me akt të veçantë.

9. Punët administrative-teknike të Këshillit

- Për punët administrativo-teknike dhe çështje tjera lidhur me punën e Këshillit është përgjegjës Kuvendi Komunal.

10. Këshilli përcakton rregullat e procedurës për punën e tij.

11. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlej Vendimi për formimin e Këshillit të Ekspertëve për Planifikim Zhvillimor të Komunës së Gjilanit, nr.01. Nr.5797 i datës 19.05.2010.

12. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Nr.01. 16-46086
Gjilan, më 24.04.2014

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku-Rexhepi